

THESAURUS OF THE CHILDREN WORLD SINONIMIK I ILUSTRUAR PËR FËMIJË (THESAURUS)

Nikoleta KALLDRËMXHIU¹

^{1*} Department of Lexicology, Academy of Albanological Studies

*Corresponding author e-mail: nikoleay@yahoo.com

Përmbledhje

Qëllimi i këtij mëtimi ishte nxjerra e sinonimeve dhe antonimeve prej grupeve të fjalëve që dalin në fushën semantike të botës shpirtërore dhe materiale të fëmijëve. Kjo do t'i shërbejë paraqitjes së tyre në një sinonimik të ilustruar për fëmijë. Duke shfrytëzuar fushën leksikore dhe togfjalëshin si burim i parë i kontekstit, përzierja e deduksionit me induksionin si metodologji bëri më të lehtë saktësinë e arritjes sonë e për rrjedhim fëmijën që do të zhvillohet nëpërmjet fjalorit. Punimi jep qasje të zbërthimit gjuhësor të togfjalëshit duke e bërë këtë të fundit burim të sinonimive të reja të botës së fëmijëve. Ideja se mësimi i gjuhës bëhet më mirë me togfjalësha, është vërtetuar duke sjellë shembuj konkretë të potencialit të tyre, si instrument që i shton kompetencës komunikative të fëmijëve thellësi, ngjyra dhe variacione leksikore.

Fjalët kyçe: *kontekst, fushë leksikore, togfjalësh, familje semantike, shndërrime gjuhësore, thesaurus.*

1. Hyrje

Njohja e fjalës nga njëra anë dhe nga ana tjetër e burimit se nga është marrë njohuria për të, do të thotë t'i shtosh anën tjetër të medaljes procesit të të mësuarit. Prof. Memushaj thotë se puna e gjuhëtarit i ngjan asaj të fëmijës që mëson gjuhën. E duke ditur se mësimi i gjuhës bëhet më i mirë i shoqëruar me togfjalësha,⁹⁸ ne do të ndalemi tek ky i fundit, si mjet për pasurimin e fjalorit.

Togfjalëshi në jetën e përditshme përfaqëson fjalë të lidhura që përdoren bashkë. P.sh., ujë i kripur, e kuqe flakë, dashuria për vendlindjen, e dënoi fati etj. Nga pikëpamja gjuhësore togfjalëshi është njësi ndërtuese, prej të cilit ndërtohet fjalia. Kjo e fundit është burim i kontekstit për shpjegimin e fjalës dhe mendoj se edhe togfjalëshi mund të shërbejë si i tillë. Nga ana tjetër nuk e kemi përjashtuar faktin, se jo të gjitha lidhjet e fjalëve në togfjalësh ofrojnë shpjegime për fjalën, pra nuk janë burim konteksti.

⁹⁸ Shih R. Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Tiranë 2006, fq.263

Shih V. Memisha, Studime për fjalën shqipe, 2011, fq. 6

Në praktikën mësimore në Republikën e Shqipërisë termi togfjalësh përdoret si togu, GE (grupi emëror), GF (grupi foljor).

Le të shohim konkretisht leksematikën e fjalëve të fushës tematike të botës shpirtërore dhe asaj materiale të fëmijët e CU. Ne kemi zgjedhur tematikën shpirtërore të fëmijët se aty fjalët janë polisemantike, pra ofrojmë një valencë të gjerë lidhjesh me fjalë të tjera. Ato janë fjalët dhe togfjalëshat e zgjedhur të shkrimtarëve, të gatshme më tej për stil në përshkrime, opinione e argumente. Tematika materiale si konkretja bëhet plotësuese e asaj shpirtërore.

2. Togfjalëshi dhe konteksti

Duke iu kthyer sërish analizës së togfjalëshit citojmë Prof. Jani Thomain (Leksikologjia e gjuhës shqipe, fq 134): “Në këtë zbërthim kemi ***mundësi*** të zbulojmë lidhjet e fjalëve me vlerat që kanë kundrejt njëra- tjetrës. Por kjo na ndihmon për të përcaktuar kuptimin e vetë fjalës [...] Shembujt e sjellë prej tij, si vlerë të fjalës kundrejt njëra-tjetrës *flas shkurt* e *bie shkurt* shënojnë kuptimin e parë dhe të dytë të ndajfoljes, ndërsa në fjalorin sinonimik *shkurt*, *prerë* dhe *shkurtas* paraqiten si sinonime të së njëjtës fjalë.

Zbulimi i sinonimisë nëpërmjet parafrazimeve⁹⁹ (fjalë e shprehje të vështira, të pazakonta e të vjetra zëvendësohen me sinonimet e tyre) në mënyrën më të thjeshtë është një nga qëllimet e këtij punimi. Ne jo vetëm do t'i përshkruajmë lidhjet e fjalëve në togfjalësh, por do të shohim dhe rregullsinë gjuhësore, gramatikore, stilistike me të cilën ato janë të lidhura. E tillë kjo është një **metodë e kombinuar**¹⁰⁰ e induksionit dhe deduksionit që do të na lidhë shembujt konkretë me një qasje teorike. **Pra në vërtetimin se konteksti është tërësia e fjalorit dhe gramatikës që rrethon fjalën.**

3. Përvetësimi i gjuhës sipas karakteristikës moshore

Nga pikëpamja pedagogjike nuk shtojmë diçka të re nëse flasim për cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet strategjisë së mësimi të fjalorit. Por duhet të theksojmë vëmendjen e duhur të punës me gjuhën në këtë grup moshe dhe punës me nxënësit në përgjithësi. Vëmendja dhe kujdesi ndaj nxënësve të kësaj grupmoshe (Cikli i ulët i sistemit 9-vjeçar¹⁰¹, motivohet nga fakti se në këtë etapë hidhen themelet e një formimi të plotë e të qëndrueshëm gjuhësor, që do të sigurojë vazhdimësinë e tij në ciklet e tjera arsimore.

Kjo bazohet në veçori psikologjike të moshës dhe aftësisë për të përthithur, riprodhuar dhe memorizuar gjuhën dhe elementet e saj. Megjithatë, përgatitja gjuhësore e tyre, sot e kësaj dite, ende paraqitet problemore, pasi ato, hera-herës, por dhe në mënyrë të përsëritur, pasqyrojnë mangësi dhe boshllëqe gjuhësore, teksa shprehen me gojë dhe me shkrim. Nga ana tjetër mësimi nga shtëpia i cili erdhi si nevojë e detyruar e arsimit e shtron nevojën për fjalor për këtë grup-moshë

⁹⁹ Gjuha shqipe Albas klasa X, 2016

¹⁰⁰ Togfjalëshin dhe parafrazimin e tij i mendojmë si një shprehje $A \pm B \sim N$. E kemi shndërruar B(fjalë përcaktore;kundrinore) në sinonimin e saj B1 dhe A (fjala drejtuese) në sinonimin e saj a1 , me qëllimin që A të rishkruhet si b1,ose a1 +b1. Mundësitë e ndryshme të parafrazimeve N që dalin mund të përdoren sipas nevojës dhe gjykimit. Fjalët shërbyese si parafjalët dhe nyjat nuk luajnë rol në transformimin e shprehjes. Shembulli 2 i tabelës 1 është edhe rishkruar në këtë mënyrë.

¹⁰¹ Termi *grup-moshë* përdoret me kuptimin e klasifikimit dhe grupimit të një nënkategorie moshore brenda ndarjes së gjerë moshore, sipas konceptimit didaktik dhe psikolinguistik. Ndërsa në draftin “Dokumenti i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014 – 2020”, Tiranë, 2014, f. 15, thuhet shprehimisht: *Arsimi bazë u ofrohet fëmijëve të moshave mbi 6 vjeç, zgjat 9 vite dhe është i detyruar. Struktura e arsimit fillor, si arsimi i detyruar ka ndryshuar me planin e ri mësimor të vitit 2004. Në bazë të kësaj strukture, kohëzgjatja aktuale është 5 vjet. Nxënësit i frekuentojnë IA-të që ofrojnë arsim bazë deri në moshën 16 vjeç.*

si domosdoshëri. Kjo jo vetëm në planin pedagogjik , por edhe në atë social e shoqëror, ku fëmija zhvillohet nëpërmjet një parametri tjetër social siç është imagjinata krijuese. Fjalësi i mëposhtëm tregon se fjalët tërheqin më tepër vëmendjen e fëmijës. Ato lënë një mbresë të veçantë nëse thellohesh në kuptim.

Fjalës¹⁰² i shoqëruar me togfjalësja te lirë që shprehin botën shpirtërore të fëmijës

mall	më ka marr malli, pres me padurim
lajkë	e marr me lajka, tërë lajka
dashuri	dashuria e prindërve, i dashuruar pas luleve dhe fluturave, vjen nga dashuria,
dhurojini miqësi e dashuri, malli dhe dashuria për vendlindjen	
djersë	fshij djersët
kënaqem	u kënaqën nga ndryshimi, u kënaqem me lodra, , është kënaqur më tepër, e
lexova me kënaqësi, kënaqem më tepër, kënaqem në mësim	
keq	të vjen keq
qejf	nuk i kam qejf pijet
fuqi	me gjithë fuqinë, me fuqinë e tij
lumturi	të lumtur pranë njëri-tjetrit, pak lumturi të ndrisë, u lumturua nga ngrohtësia e tij,
ju uroj lumturi	
lumtur (i,e)	fund i lumtur
lutem	iu lut me shpirt
ëndërr	jastëku i ëndrrave, donte të fluturonte, më del në ëndërr,
interesoj	nuk të interesojnë librat
vete	ndihej mirë, mirë me veten, ndihej shumë i vetmuar, ruaj brenda vetes
skuq	u skuq dhe uli kokën, iu skuqën faqet nga turpi, u skuq dhe belbëzoi
ndiej	ndihem më i rëndësishëm, ndihem modern, nuk e duroj dot , rimerrte veten, të duket vetja
magjeps salla u magjeps	
pendim	pendimi po e gërryente, e gërryente nga brenda
zell	me zell të madh
habi	për habinë time
dëshirë	plotësoi dëshirën, kam dëshirë të njoh, ke dëshirë të plotësosh, dëshirën
dhe shijen për të lexuar	
mendimi	m'u krijua mendimi, mendimet në hartim,
mendje	e ngulit në mendje
fantazi	përfytyrime me fantazi
gëzim	me gëzim të madh nisëm udhëtimin, u hodh përpjetë, u hodh nga gëzimi,, ndajmë
gëzimet, ndajmë bashkë, u kthyen të gëzuar, u kthym në kopsht, fli gëzim e pusho	
gëzoj	gëzofsh emrin, gëzuar ditëlindjen, gëzuar festën e mësuesit,
gëzuar krishtlindjet	
urrej	urrej errësirën
çudi	çudirat e javës, vajzë e çuditshme
frikë	ka frikë nga fantazmat, ka frikë luftërat, ka frikë vetëm,
përkëdhelje	përkëdhelje e nënës
inat	vështrim me inat,
forcë	forcën e alfabetit, forca e gjuhës shqipe

¹⁰² Fjalësi është vjelë nga tekstet mësimore të gjuhës shqipe te CU, ashtu sic pëshkruhet në literaturën burimore paraqitur në referenca.

<i>pranoj</i>	<i>pranoj me dëshirë, nuk pranon të flejë</i>
<i>pëlqen</i>	<i>më pëlqen shumë</i>
<i>zemëroj</i>	<i>nuk duhet të zemërohem,</i>
<i>mëri</i>	<i>nuk mbaj mëri</i>
<i>pëlqej</i>	<i>më pëlqen të luajmë, të luajmë të gëzuar, më pëlqen shëtitja, shëtitja me varkë,</i>
<i>dhuroj</i>	<i>kërkoj t'i dhuroj, dhuroj dashuri dhe miqësi, t'i dhuronte dhimbsurinë</i>
<i>ndaj</i>	<i>ta ndajmë secilin, të ndajmë veç , duke ndarë çaste, çaste të veçanta, çaste</i>
<i>miqësie e lumturi</i>	
<i>quaj</i>	<i>ndaj më quajnë</i>
<i>madh (i)</i>	<i>je e madhe</i>
<i>di</i>	<i>dinte të qeshte dhe të këndonte, ditke të bësh, të bësh shaka</i>
<i>zemër (fig)</i>	<i>shkruan me zemër, shfreu zemrën, hapi zemrën, zemra flet shqip, zemra iu mbush, iu mbush me gëzim, në zemër më ka mbirë, bota e fëmijëve, të duan të gjithë, më pëlqen natyra, falënderoj me zemër</i>
<i>mbrapshtë (i,e)</i>	<i>ditë e mbrapshtë</i>
<i>gulçoj</i>	<i>arrin duke gulçuar</i>
<i>ters</i>	<i>shkon ters</i>
<i>fund</i>	<i>fund i lumtur, e bukura dhe e mira s'kanë fund</i>
<i>tensionuar(i, e)</i>	<i>i tensionuar kur shkruaj</i>
<i>simpatik/e</i>	<i>më simpatiku i klasës</i>
<i>dënesë</i>	<i>dënesa i mbyti krahatorin</i>
<i>ri (i)</i>	<i>burrë i ri</i>
<i>panik</i>	<i>kapi paniku</i>
<i>naze</i>	<i>tërë naze</i>
<i>honeps</i>	<i>s'honeps vajzat (nuk i pëlqej vajzat)</i>
<i>krah</i>	<i>mbërthej nga krahët</i>
<i>një</i>	<i>çapet e para</i>
<i>nder</i>	<i>nderojë udhën</i>
<i>fat</i>	<i>e ka dënuar fati,</i>
<i>mërzi (toni i zërit)</i>	<i>trishtim (shprehja e syve) zemërim (rrudhja e ballit)</i>
<i>shijoj</i>	<i>gazmend të pranverës, ndjell me imagjinatë, tallaz me vargun naimian, njerëz të mirë, shpikës, zbuti idhnaket, nuk ngopej së shikuari, ulem vërtik, njerëz të varfër, princ i lumtur, ofshamë e thellë, erdhi paqja</i>
<i>kokë</i>	<i>uli kokën</i>
<i>humb</i>	<i>e humbi toruan</i>
<i>rrit</i>	<i>të rris babë e nanë!</i>
<i>festë</i>	<i> festa e abetares</i>
<i>suksese</i>	<i>suksese në mësim</i>
<i>uroj</i>	<i>uroj mësuesen¹⁰³</i>

¹⁰³ B.Beci, gjuha matare 2006, fq 8

Shndërrimet gjuhësore dhe sinonimia

Tabela 1.

shenja ~ tregon parafrazimin e togfjalëshit

<u>lidhjet emër +emër me parafrjalë</u> <u>A.Me parafrjalën në</u> krijoj shkruaj krijim hartoj 1.Mendimet në hartim shkruaj idetë ~shkruaj përshtypjet Ide, përshtypje Përfitim(b1) shkollë në mësim(B) ~sukses në shkollëA+b1 ~fitofshi!2b1 Fitim(b1) <u>B.me parafrjalën për</u> Konotative: rehat, familjaritet, ngrohtësi Shtëpi rilindje 3. Dashuri për vendlindjen ~dashuria për shtëpinë ~rilindje përkushtimi shtëpi 2. Malli për vendlindjen ~dhimbsuria ~përmallimi dashuri e shenjtë (sipas Konicës) dhimbsuri i dhemb (ndjen keqardhje)	<u>ment</u> 1. Gjymtyra e prirë nga parafrjala tregon vendin ku shkojnë, ku kufizohen mendimet Togfjalëshi shpreh raportin midis kompetencës dhe performancës Sin:hartoj, krijoj, ideoj, shkruaj 2.Gjymtyra e dytë e prirë nga parafrjala tregon vendin ku shkojnë sukseset, pra në shkollë. Folja në mënyrën dëshirore shpreh intensifikimin e veprimit Sin:mësim, shkollë Sin:sukses,fitore, përfitim 3.Gjymtyra e dytë e prirë nga parafrjala tregon çështjen për të cilën bëhet fjalë =rilindje (lidhur me një kontekst të mirënjohur të lëvizjes së Rilindjes Kombëtare) Sin:dashuri,rilindje, intimitet,familjaritet, ngrohtësi, rehati, shtëpi 2.Bëhet fjalë për mallin për shtëpinë, që është një lloj dashurie, por e shoqëruar me ndjenjën e trishtimit= homesick(angl) Sin:mall,dhimbsuri,përmallim
---	---

Nëse do të na duhej të shpjegojmë kuptimin e fjalës **mall** dhe **dashuri** në tekstin **Malli për atdheun** i F. Konicës, gjuha shqipe klasa 9, konteksti i gjerë i gdhendur me fjalën e autorit do të na e sqaronte gjerësisht.” S’di ç’të **mungon**, s’di ç’të duhet. Një hije **trishtimi** ta mbulon fytyrën...i shenjtë mall e dashuri e shenjtë, kush është ai shqiptar që s’e ka pasur në dhe të huaj”

Por nëse do ta sqarosh në klasën e pestë nga fragmenti i shkëputur nga histori e Skënderbeut: “Malli dhe dashuria për atdheun nuk më lanë t’i shërbeja sulltanit gjatë, po më sollën në mes tuaj mes vëllezërve. Ç’fat i madh e mirë! Cili nuk do ta dëshironte këtë fat? Cili nuk do ta kishte lakmi”, Fëmija do të ishte konfuz për të kuptuar pse Skënderbeu nuk i shërbente sulltanit. Interpretimi mbështetur në analizën e togfjalëshit do të ishte: Ne e duam shtëpinë tonë dhe trishtohemi kur jemi larg saj. Prandaj dhe Skënderbeu nuk mund t’i shërbente sulltanit.

Tabela 2

<u>Lidhjet emër+emër me parafjalën me</u> imagjinatë 1. Përfytyrime me fantazi~fantazoj ~imagjinoj Përfytyroj Imagjinoj ~ I inatosur 2.Vështtrim me inat~ vrenjt ~me zemërim Shikim Vërejtje Qortim <u>Lidhja folje+emër me parafjalën me</u> pres ~ pres me entuziazëm 3.Pres me padurim~ nuk duroj dot Duroj 4.E lexova me kënaqësi~kënaqem 5.U kënaqëm me lodra-lodrova ~u zbavita	1. Gjymtyra e dytë e prirë nga parafjala me tregon një tipar, një cilësi të ngjashme Sin:përfytyroj, fantazoj,imagjinoj 2. Gjymtyra e dytë e prirë nga parafjala tregon mënyrën se si kryhet veprimi Sin:inatosem,zemërohemfig vrenjtem 3.Gjymtyra e prirë nga parafjala tregon mënyrën si kryhet veprimi Sin: pres, duroj Sin:padurim, nuk duroj kontekst entuziazëm Sin;lexoj, kënaqem  5.Sin:lodroj, zbavitem
---	--

Kënaqem 6.Kënaqem me mësim²¹⁰⁴ 7.Iu lut me shpirt~ përshpirtem Parashikoj marr me mend 8.Ndjell me imajgjinatë~marr me mend ~parashikoj	sin:kënaqem, lodroj, zbavitem 6.Sin:mësoj, kontekstuale kënaqem 7.Sin:lutje, përshpirtje 8.Sin:ndjell, parashikoj, marr me mend
--	---

Tabela 3

<u>Lidhja emër +emër në gjinore</u> kujdes Kujdestar të dashurit 9 Dashuria e prindërvë~përkujdesje jap ~prindërore Fig. fole 10.Përkëdhelje e nënës~ mban të përqaftuar në gjoks 11.Forca e alfabetit~forca e gjuhës Do kontekst me të gjere. fëmijëria 12.Bota e fëmijëve ~fëmijëria veprimtari	9.Gjinorja shërben për të treguar atë që e kryen veprimin e ardhur nga emri prejfoljor. Fjala kujdes dhe kujdestar i përkasin të njëjtës familje semantike. Sin: dashuri, përkujdesje Sin: prindërit, të dashurit, kujdestarë sin:dashuri, kujdes, përkujdesje nëse duam ta përforcojmë përfundimin tonë me një kontekst më të gjerë I referohemi shkrimit të atë Gjergj Fishtës <i>prind I mirë</i> (Gj. Fishta-vepra letrare 10m fq 238). Zgjedhja jonë e fjalës përkujdesje si sinonim është për ta dhënë të plotë kuptimin e togfjalëshit, pasi prapashtesa për është përforcuese.
--	---

¹⁰⁴ Sipas konceptit të shfaqur te shkrimi *Pengesat në kënaqësinë e studimit, gjuha shqipe* 9, botimet Pegi, fq 171,2020

13.Simpatiku i klasës <u>lidhja emër +emër me parafjalën nga, brenda, në</u> 14.Ruaj⁹ brenda¹ vetes~fraz.i ruan brenda ↗Mbaj të fshehtë 15. E mbërthej nga krahët^{forcë} e kapi me forcë ↗Kap me forcë 16.Del në ëndërr. <u>Emër + formë e pashtjelluar</u> bis. zgjedh ~përzgjedhje zgjedhje ↗ ~parapëlqim ↗17.Shijen për të lexuar~kënaqësia e leximit ↗Oreks, endje, kënaqësi, parapëlqim, gusto, preferencë	10.Sin: përkëdhelje, përqafim  12.Fjala fëmijë dhe fëmijëri i përkasin të njëjtës familje semantike Sin:botë,fëmijëri, veprimtari 13.Ka nevojë për kontekst të mëtejshëm 14.Fjala ruaj bashkohet me brenda me kuptin e saj të nëntë, ndërsa brenda me atë të parin. Sin: brenda, mbyllur, i fshehtë 15.Parafjala nga tregon drejtimin e veprimit. Pra kuptimi i shprehjes është Sin: Krahë, forcë Parafjala nga del sinonime me për: e mbërtheu për fyti, për beli, flokësh. Në të gjitha rastet perifrazimi është i njëjtë. Por bashkëvajtja me fjalën mbërthej do të qëndronte me parafjalën nga për togëfjalëshin e mbërtheu nga krahët. 16.Duhet kontekst më i gjerë. 17.Forma e pashtjelluar në këtë rast ka funksion përcaktor. Pra aftësia për të kuptuar, parapëlqimi, kënaqësia, endja për leximet. Më tej mund të bëhet një përkufizim i fjalës kënaqësi ose një
---	---

	kontekst më i gjerë për të parë fjalën më të saktë të vargut sinonimik. Sin: shije, përzgjedhje, parapëlqim, kënaqësi
--	---

<u>Lidhja emër + folje</u> 18. Salla u magjeps~magjepsje 19. Pendimi e gërryente~i shqetësuar ↙ keqardhja ↘ Fig. Shqetësoj <u>2.Lidhja folje + emër</u> 20. Dhuroj dashuri~i fal ↙ Jap pa pritur në këmbim ↘ Falas ↘ fal 21. Kam qejf pijet 22. Kam qejf udhëtimin~kënaqem ↙ kënaqem 23. Më interesojnë librat~i kam hobi ↙ tërheqje ↘ argëtim ~më tërheqin 24. Iu skuqën faqet u turpërua 25. U skuq nga turpi~u turpërua 26. Gëzoj festën~festoj ~gazmoj	18. Konotacioni i fjalës sallë në shqip është e bukur, magjepsëse. 19. Sin: gërryëj, shqetësoj Pendim, keqardhje 20. Fjala fal dhe falas i përkasin të njëjtës familje semantike¹⁰⁵ Sin: dhuroj, fal, devocion 21. Është e drejtpërdrejtë. 22. Sin: qejf, kënaqësi 23. Sin: interes, tërheqje, hobi Konotacioni i fjalës <i>libër</i> në këtë moshë lidhet me librin artistik. Kjo shkon me aktivitetet që e zbavitin atë. 24. Kuptimi konotativ i <i>të kuqes</i> në kulturën shqiptare është turpi. Perifrazimi: iu skuqën faqet=u turpërua 26. Sin: gazmoj, festoj
---	---

Fjalës i shoqëruar me togfjalësha që shprehin botën materiale të fëmijës

dhomë dhomë e mjekut, dhomë e gjumit, dhomë e pritjes,

shtëpi shtëpi pushimi, shtëpi e sigurt, shtëpi në pemë, shtëpitë e vjetra, shtëpi e ëmbla.

qytet qytet i lodrave, qytet muze

lodër dyqan lodrash, kënd lojërash, qytet i lodrave, kafshë lodër, kub lodër, prodhuesi i lodrave, kohë e lojës, lë lojën, lojë popullore, lojëra elektronike

¹⁰⁵ Sh. Rrokaj, Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme, Tiranë 2005. fq 117.

shkollë ditët e shkollës, shkollë fshati, shkollë qyteti, shkollë e mesme, shkollë publike, shkollë jopublike, shkollë muzike, arrij në shkollë, tekste shkollore

libra libra të mrekullueshëm

aeroplan fluturoj me aeroplan,

<u>Lidhja folje +emër</u> 27.Fluturoj me aeroplan~fluturoj 28.Lë lojën~nuk luaj më 29.Libra te mrekullueshem =mrekulli	27.Togfjalëshi barazohet me kuptimin e fjalës drejtuese 28.Sin kontekstual: le lojën, Çlodhem, largohem 29.Sin kontekstual:libër, mrekulli
---	---

4. Përfundime

Pyetjes se a ka forcë gjuha të ndikojë në mënyrën se si njerëzit shohin botën, ne i përgjigjemi pozitivisht. Sikurse lidhja midis dy njerëzve që kuptohen i forcon, duket se dhe lidhja midis dy fjalëve ka efekt përforcues. Nevoja për komunikim rrit edhe interesin tonë për të. Veç kësaj, duke kujtuar se nuk kemi të bëjmë me një gjë të pazakontë po të themi, që gjetja e fjalës së duhur do të thotë edhe gjetja e jetesës së duhur.

Shembujt që po i japim sot, besoj, se na çojnë drejt një qasjeje të drejtë të mësimin të fjalorit. Ato na japin dorë në qëmtimin e togfjalëshit, si burim i parë dhe i sigurt i kontekstit dhe mund të japë një ndihmesë në studime të tjera në mësimin e fjalorit të gjuhës shqipe. Vumë re se: a) togfjalëshi emër +emër me parafjalën *për*, mund të barazohet me një fjalë të prejardhur me parashtesën *për*, p.sh: malli për vendlindjen =përmallem.

Nëse fjala përcaktuese pas zbërthimit morfologjik apo leksikor ka pothuaj të njëjtën vlerë sinonimike dhe morfologjike me fjalën drejtuese, ajo mund të shërbejë si rrënjë për fjalën e prejardhur, p.sh: përkujdesje=dashuria e prindërve. Edhe lidhjet folje+emër mund ta realizojnë një kalim të tillë gjuhësor, p.sh: iu lut me shpirt=përshpirtem, pavarësisht se *për* mungon. Parafjala *me* është përforcuese dhe tregon intensitetin me të cilin kryhet veprimi.

Në këtë kategori, por pa parashtesën *për*, do të fusim togfjalëshat folje +emër ku njera fjalë mund të barazohet me togfjalëshin duke ndërruar kategorinë gramatikore, p.sh.; vështroj me inat=inatosem, gëzoj festen=festoj, gazmoj, etj. Por jo të gjithë togfjalëshat mund të shërbejnë si burim konotacioni. Nga 29 togfjalësha të shqyrtuar 2 prej tyre nuk kishin potencialin për shpjegim. Lidhjet që shprehin emrat me mbiemrat zakonisht bëhen burim i kompozitave, p.sh.: me zell të madh=zellmadh, djalë i vogël=vogëlush. Ndërsa lidhjet me përemrat do t'i konsiderojmë të paafta për kontekst.

Togfjalëshat ku njëra nga fjalët ka konotacion p.sh. u bë pehlivan, iu skuqën faqet, malli për vendlindjen, zbërthimi i togfjalëshit të bëhet si në kuptimin denotativ të fjalës ashtu edhe në atë konotativ. Këto janë asosacione semantike, ku fjalët lidhen me njëra-tjetrën për sa i përket kuptimit konotativ. Togfjalëshi *ndaj çaste, dënoj fati fjalët ndaj dhe fat* zbulojnë antonimi. Një rishkrim i mundshëm me modelin me sintagma që do të përfshinte më shumë shembuj, do të ishte një ndihmesë për semantikën interpretuese apo atë gjenerative të gjuhës shqipe.

Ritheksojmë se prirja për thjeshtësi dhe stil duhet ta shoqëroj leximin dhe krijimin sidomos në këtë grup-moshë, e cila ka edhe parametrat optimalë për të ardhmen e begatë individuale dhe kolektive. Nga F. Shiroka citojmë : “Por ka mbetë i vorfën nj’ ai qi në rini

As urti s’ka mësuem kurrë, as dituni”.

Ndaj dhe një thesaurus¹¹⁰⁶ i fëmijëve është jo vetëm një nevojë e kahershme e leksikografisë shqiptare, por dhe një domosdoshmëri bashkëkohore edukimi. Konteksti për kompozim do të motivonte në rrugën e krijimtarisë. Ashtu siç ka vepruar Konica, Fishta, besoj, se secilit prej nesh, do t’i lindte dëshira për të dhënë shembuj të përvojës së tij në njohjen e jetesës, kulturës vetjake nëpërmjet artit të letrave.

Referencat

- [1]. Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj, Lindje dhe dy perëndime, 2008.
- [2]. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i shqipes së sotme*, Toena, 2002.
- [3]. Gj. Shkurtaç, Sociolinguistika. Tiranë, 2005.
- [4]. *Investigation in philosophical semantic*, Seven Bridges Press, 2005.
- [5]. J. Aitchison, *Word in the mind: An introduction to the mental lexicon*. Handbook. Cambridge University, 1997.
- [6]. J. Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë, 2001.
- [7]. J. Thomaj, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008.
- [8]. J. Thomaj, M. Samara, H. Shehu, Th. Feka, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005.
- [9]. J. Thomaj, M. Samara, H. Shehu, Th. Feka, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2005.
- [10]. J. Thomaj, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë 2009.
- [11]. J. Thomaj, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992..
- [12]. F. Shiroka: *Zani i zemrës, tiranë Shtëpia botuese Naim Frashëri, 1986*
- [13]. Jon Lyons, *Semantics*, Language University Press, 1977.
- [14]. M. Samara, *Çështje të antonimisë të gjuhës shqipe*, 1985.
- [15]. M. Samara, *Çështje të antonimisë të gjuhës shqipe*, 1985.
- [16]. N. Chomsky, *Aspects of the theory of syntax*, 1965.
- [17]. N. Chomsky, *Topics in theory of generative grammar*, Mouto, La Haye, 1969.
- [18]. *Oxford for synonym and antonyms*, Oxford University Press, 1999.
- [19]. *ristotelit*.
- [20]. N. Kalldrëmshiu, *Zhvillimi psikomotor dhe rritja e kompetencës gjuhësore te fëmijët nga 0-12 vjeç*, Tiranë 2017.
- [21]. R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Botimet Toena. Tiranë, 2006.
- [22]. R. Vasta, M. Haith, S. Miller, *Psikologjia e fëmijës*, 1992.
- [23]. Rr. Paçarizi, *Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë*, Prishtinë, 2011.
- [24]. Singer, D. G. & Revenson, T. A., *A Piaget Primer: How a Child Think*, New York: Plume. 1996.
- [25]. Skinner, B. F., *Verbal Behavior*, New York: Appleton-Century-Crofts, 1957.

¹⁰⁶ Fjala thesaurus = një thes me ar, besojmë se mund të përdoret po kështu në shqipe për të dhënë përkufizimin më të mirë për një fjalor sinonimik. Fjala thesar në shqipe do të thotë një thes me ar. Po të shohim edhe studime në google ky përdorim është i përligjur.

- [26]. Stephen Crain, Rosalind Thornton, *Acquisition of Syntax and Semantics, Section 3: Language Development*. Handbook of Psycholinguistics. Second Edition, 2006. Isbn-13:978-0-12-369374-7. www.ucd.ie .
- [27]. Sh. Islamaj, Roli i sinonimisë në pasurimin e gjuhës, në “*Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve, në gjuhën shqipe III*”, Tiranë 1989, fq 359-366.
- [28]. Sh. Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 2*, Tiranë, 2009.
- [29]. Sh. Rrokaj, *Filozofia e gjuhës*, Tiranë, 2010.
- [30]. Sh. Rrokaj, *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Tiranë, 2005.
- [31]. Sh. Rrokaj, *Strukturalizmi klasik në gjuhësi*, Tiranë 1984.
- [32]. T. Gjokutaj, *Hyrje në historinë e letërsisë për fëmijë*, 1998.
- [33]. T. Plangarica, *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar*, Sejko, 2002.
- [34]. Memishaj, *Rreth shndërrimit të togfjalëshit të lirë në njësi frazeologjike*, SF 3-4/2006.
- [35]. R. Petro & M. Gjokutaj, *Gjuha shqipe 2*, Albas, Tiranë, 2006. Ribotim 2009.
- [36]. M. Gjokutaj, *Gjuha shqipe 3*. Shkronjë pas shkronje, Tiranë, 2007.
- [37]. Beci, *Gjuha amtare 3*, Shkronjë pas shkronje, Tiranë, 2005.
- [38]. R. Petro & N. Pepivani, *Gjuha shqipe 4*, Albas, Tiranë, 2006. Ribotim 2009.
- [39]. R. Petro & N. Pepivani, *Gjuha shqipe 5*, Albas, Tiranë, Prishtinë, Tetovë 2009. Ribotim. 2011.
- [40]. *Fjalor i parë i ilustruar i gjuhës shqipe për klasën e parë*, Botimet Tafa.
- [41]. *Kurrikula kombëtare e arsimit bazë, Program lëndor, Fusha: gjuhë shqipe dhe letërsi Lënda: gjuhë shqipe Klasa: 1- 9*. Tiranë, 2012, 2014.
- [42]. J. Thomaj etj., *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*,
- [43]. Dhrimo, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007.
- [44]. Y. Basha, V. Dheri, *Fjalor mësimor anglisht-s*.